



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOLEGJI ZGJEDHOR GJYQËSOR
TIRANË

Nr.17 Regj.Them.
Datë Rregj.06.05.2023

Nr.17 Vendimi
Datë 09.05.2023

V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor në Tiranë, me trup gjykues të përbërë nga:

Gjyqtar: Sokol IBI (*Relator*)
Gjyqtare: Blerona HASA (*Anëtare*)
Gjyqtare: Edlira PETRI (*Anëtare*)
Gjyqtare: Manjola XHAXHO (*Anëtare*)
Gjyqtare: Alma KOLGJOKA (*Anëtare*)

me sekretare gjyqësore Ermelinda Nuraj, sot më datë 09.05.2023, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, mori në shqyrtim çështjen me nr.17 akti, datë 06.05.2023 që i përket:

PADITËS: **Partia e Lirisë**, me seli: Rr. "Sami Frashëri" Godina 20/10, Tiranë, përfaqësuar me autorizim Nr.404/1 Prot datë 05.05.2023 nga Av.Altin Kaziaj, me Nr.6558 liçense, Dhoma e Avokatisë Tiranë.

IPADITUR: **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**, përfaqësuar në gjykim me autorizim me nr. 4824 Prot, datë 08.05.2023 nga Blendi Kodra dhe Blerta Ereqi.

PERSON I TRETË: **Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet**, përfaqësuar në gjykim me autorizim me nr. 390 Prot, datë 08.05.2023 nga Shkëlqim Sulo dhe Klardi Xhemali.

OBJEKTI: 1. Kundërshtimi i vendimit nr. 71, datë 02.05.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve;

2. Ndryshimin e Vendimit nr. 71, datë 02.05.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, duke vendosur: Caktimin e Partinë e Lirisë si parti politike që i lind e drejta e propozimit për anëtarin e katërt të grupeve të numërimit të votave, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023 ose në alternativë, konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Vendimit Nr.71 Dt.02.05.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve.

BAZA LIGJORE: Neni 6, paragrafi 1 i KEDNJ, Nenet 4, pika 1, Neni 9, 45, 46 e vijues të Kushtetutës së Shqipërisë, Nenet 63, 64, 65, 98, 139, 145 e vijues i Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë

Kolegji Zgjedhor në seancën e datës 09.05.2023, pasi dëgjoji pretendimet e fundit të palës paditëse që kërkoi pranimin e padisë sipas objektit, pala e paditur e la në çmim të gjykatës padinë e paditësit si dhe personin e tretë që kërkoi rrëzimin e padisë,

VËREN:

1. Pala paditëse Partia e Lirisë i është drejtuar Kolegjit Zgjedhor, duke depozituar pranë Gjykatës Administrative të Apelit, padinë me objekt “*Ndryshimi i vendimit nr. 71, datë 02.05.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve*”. Referuar përcaktimeve të Kodit Zgjedhor, brenda afatit ligjor, u caktua seanca për gjykimin e kërkesëpadisë së paraqitur, duke iu kërkuar edhe palës së paditur paraqitja e të gjithë dokumentacionit përkatës, lidhur me vendimmarrjen që kundërshtohet nëpërmjet kësaj kërkesëpadie.

I. FAKTET E ÇËSHTJES:

2. Presidenti i Republikës së Shqipërisë, me Dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

3. Pala paditëse, Partia Politike e Lirisë, me Vendimin Nr.178, Dt.18.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, është regjistruar si pjesë e koalicionit “*BASHKË FITOJMË*” (PL-PDK-PBDNJ), “BF”, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

4. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në zbatim të nenit 95, paragrafi 2 dhe nenit 96 pika 2, të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar dhe Udhëzimit të Komisionerit Shtetëror i Zgjedhjeve nr.

5, datë 16.03.2021 "Për procedurat e hedhjes së shortit për caktimin e partive politike që propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV", jo më vonë se 30 ditë para datës së zgjedhjeve, ka organizuar në seancë publike hedhjen e shortit për caktimin e partive politike që propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të Grupeve të Numërimit të Votave.

5. Me vendimin nr. 404 datë 24.04.2023 Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi dëgjoi përfaqësuesit e partive politike në KQZ, vendosi:

“1. Partia politike e shumicës parlamentare, që ka të drejtë të propozojë anëtarin e tretë të Grupeve të Numërimit të Votave është Partia Socialiste e Shqipërisë.

2. Partitë politike të opozitës parlamentare, që kanë të drejtë të propozojnë anëtarin e katërt të Grupeve të Numërimit të Votave, në bazë të rezultatit të shortit, janë:

a) Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet,

b) Partia e Lirisë.

3. Shorti zhvillohet me datë 24.4.2023 ora 12:00.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij”.

6. Pala paditëse duke mos qenë dakord me vendimin nr. 404, datë 24.04.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve pranë KQZ i është drejtuar Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, me kërkesë ankimore.

7. Në seancën e datës 02.05.2023, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve mori në shqyrtim kërkesën ankimore të palës paditëse Partia e Lirisë e në përfundim të hetimit administrativ, ka disponuar me vendimin nr. 71, datë 02.05.2023, ku ka vendosur:

“1. Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 53, datë 27.04.2023 të depozituar nga “Partia e Lirisë”, për shkak të mungesës së numrit të kërkuar të anëtarëve për vendimmarrje.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës Administrative të Apelit, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij”.

8. Referuar vendimit të marrë nga Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve rezultoi se:

Citim: "...KAS-i nuk mundi të sigurojë shumicë vendimmarrëse për gjykimin e kërkesës ankimore nr. 53, datë 23.4.2023 të paraqitur nga Partia e Lirisë. Anëtarët Elvis Çefa dhe Ledio Braho ishin të mendimit se kërkesa ankimore duhet të pranohet, ndërsa anëtarët Elvin Lako dhe Ilirjan Rusmali ishin të mendimit se kërkesa ankimore duhet të rrëzohet. Për këtë shkak, në vijim do të jepet i ndarë arsyetimi lidhur me këtë kërkesë ankimore, në fillim me argumentat për pranimin e saj dhe në vijim me argumentat për rrëzimin e saj.

Arsyetimi i anëtarëve Elvis Çefa dhe Ledio Braho:

1. Në shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 53 të paraqitur nga Partia e Lirisë me objekt "Kundërshtimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 404, datë 24.04.2023 "Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit të votave, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023; Ndryshimin e vendimit, duke caktuar Partinë e Lirisë si parti politike që i lind e drejta e propozimit për anëtarin e katërt të grupeve të numërimit të votave, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023", ne, dy anëtarët, duke mos qenë dakord me konkluzionet dhe argumentet e parashtruara nga dy anëtarët e tjerë të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (në vijim KAS) jemi të mendimit se KAS duhet të pranonte ankimin e paraqitur nga ankimesi dhe për rrjedhojë të ndryshonte vendimin nr. 404, datë 24.04.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, si dhe të caktonte Partinë e Lirisë si parti politike që i lind e drejta e propozimit për anëtarin e katërt të GNV-ve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

2. Rezulton i provuar fakti se me vendimin nr. 404, datë 24.04.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve është vendosur "1. Partia politike e shumicës parlamentare, që ka të drejtë të propozojë anëtarin e tretë të GNV-ve është Partia Socialiste. 2. Partitë politike të opozitës parlamentare, që kanë të drejtë të propozojnë anëtarin e katërt të GNV-ve, në bazë të rezultatit të shortit, janë: a) Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet; b) Partia e Lirisë". Në lidhje me bazën ligjore për përbërjen e GNV-ve, i referohemi neneve 95 pika 2 dhe 96 pika 1 të K.Zgjedhor, që më konkretisht parashikojnë se: "2. Grupet e numërimit të votave përbëhen nga katër anëtarë, ku në çdo rast një anëtar emërohet pas propozimit të partisë politike, së cilës i përket kryetari i KZAZ-së, një anëtar pas propozimit të partisë që i përket nënkryetari, ndërsa anëtari i tretë propozohet nga partitë e shumicës qeverisëse dhe anëtari i katërt emërohet pas propozimit të partive të opozitës që kanë të drejtë të propozojnë anëtarë të GNV-ve për ZAZ-të respektive, sipas procedurës së parashikuar në nenin 96 të këtij Kodi. Në vendimin për emërimin e Grupit të Numërimit të Votave, KZAZ-ja cakton një nga anëtarët si numërues të parë dhe një anëtar si sekretar. Në gjysmën e Grupeve të Numërimit të Votave numëruesi i parë propozohet nga partia më e madhe e shumicës dhe në gjysmën tjetër nga partia më e madhe e opozitës. Sekretari

i Grupit të Numërimit të Votave i përket partisë politike të kundërt me partinë që propozon numëruesin e parë. KQZ-ja me udhëzim përcakton mënyrën e hedhjes së shortit”.

“1. Partitë politike që kanë të drejtë të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV-ve, përveç partive që propozojnë kryetarin dhe nënkryetarin e KZAZ-së, përcaktohen pas hedhjes së shortit në KQZ ndërmjet listës së partive politike të shumicës parlamentare dhe listës së partive të opozitës parlamentare të regjistruara në zgjedhje dhe që kanë fituar jo më pak se dy mandate në zgjedhjet pararendëse për Kuvendin e Shqipërisë. Në çdo rast, pas hedhjes së shortit për çdo ZAZ, të drejtën e propozimit për dy anëtarë të Grupit të Numërimit të Votave e ka një parti e shumicës parlamentare dhe një parti e opozitës parlamentare”. Sa i përket zgjedhjeve të datës 14 maj 2023, në lidhje me përbërjen e GNV-ve specifikisht do i referohemi edhe nenit 183, pika 8, të K.Zgjedhor që rregullon formimin kalimtar të organeve drejtuese dhe administratës zgjedhore, në të cilin parashikohet se “8. Në zgjedhjet e para të përgjithshme dhe në zgjedhjet e para vendore, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, e drejta për propozimin e anëtarëve të KZAZ-ve, KQV-ve dhe të GNV-ve përcaktohet sipas rezultatit të zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2017 dhe konfigurimit shumicë-pakicë të Kuvendit në çeljen e tij, menjëherë pas këtyre zgjedhjeve”.

3. Ajo çka vlen të diskutohet në rastin objekt shqyrtimi administrativ, është përcaktimi i saktë i termave “partitë e shumicës qeverisëse” dhe “partitë e opozitës”. Po ashtu, vlen për t’u përcaktuar edhe momenti se kur bëhet vlerësimi për cilësimin e partive politike që kanë fituar jo më pak se dy mandate në zgjedhjet pararendëse për Kuvendin e Shqipërisë si parti të shumicës qeverisëse apo parti të opozitës.

4. Kolegji Zgjedhor i ka trajtuar në një sërë vendimmarrjesh këto koncepte. Me vendimin nr. 5, datë 06.06.2009, Kolegji Zgjedhor ndër të tjera ka arsyetuar se “Pretendimi i ngritur nga paditësit është pjesërisht i drejtë, vetëm për sa i përket pozicionit të PDK në grupin e shumicës parlamentare, qysh pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2005. Në nenin 96 të Kodit Zgjedhor ligji ka përcaktuar termin “shumicë parlamentare” dhe “opozitë parlamentare”. Si kundër parashtron dhe përfaqësuesi i palës paditëse, në kërkesë padi, PDK është forcë politike e qendrës së djathtë dhe pjesë e bashkëqeverisjes së saj të fundit. Pozicionimi i saj i fundit pak kohë para zgjedhjeve të reja të 28/06/2009 nuk mund të ndryshojë faktin që ka qenë pjesë e mazhorancës qeverisëse; duke qenë konkurruese në këto zgjedhje, me të gjitha partitë e spektirt të djathtë, kjo palë është në opozitë me të majtën. ... Nga analiza e përmbajtjes së neneve 95 e 96 të Kodit Zgjedhor, momenti me të cilin duhet vlerësuar përkatësia në shumicën parlamentare apo opozitën parlamentare nuk është pozicionim faktik, apo në kohën kur ka rezultuar vendimi i KQZ, në lidhje me sa më lart, sikundër prapëson pala e interesuar përfaqësuesi i Partisë Demokratike.

Njëkohësisht, pretendimi i palës së paditur KQZ se në këtë rast është mbështetur dhe në përmbajtjen e shkresës nr. 1109/3 datë, datë 27.04.2023 depozituar nga partia politike 'Partia e Lirisë' 19.05.2009 të Kuvendit të Shqipërisë, që reflektohet në pjesën arsyetuese të vendimit, është i pabazuar në ligj pasi mund të shërbejë si orientim, por nuk mund të zëvendësojë ligjin". Në vendimin nr. 19, datë 08.06.2015, Kolegji Zgjedhor ka arsyetuar ndër të tjera se "Është fakt se paditësi PDIU, aktualisht është parti e shumicës qeverisëse, dhe si e tillë asaj i lind e drejta të propozojë për anëtarin e tretë të GNV-së, në hedhjen e shortit, nga kërkimi i cili është hequr dorë gjatë gjykimit. Pala paditëse PDIU, duke qenë një parti e shumicës qeverisëse, ajo nuk legjitimohet të kërkojë të bëjë propozimin e anëtarit të katërt që i përket partive të opozitës që kanë të drejtë të propozojnë anëtarë të GNV-së, për ZAZ-në, sipas procedurës së parashikuar në nenin 96 të K.Zgjedhor". Në vendimin nr. 9, datë 20.06.2017, Kolegji Zgjedhor ka arsyetuar ndër të tjera se "Referuar dispozitave të mësipërme Kolegji Zgjedhor çmon se ka një kontraditë midis nenit 95/2 dhe nenit 96 të K.Zgjedhor ku në njërën përcakton "partitë e shumicës qeverisëse" dhe nga ana tjetër i referohet "partive politike të shumicës parlamentare dhe listës së partive të opozitës të regjistruara në zgjedhjet pararendëse për Kuvendin e Shqipërisë". Pra nga njëra anë kemi parti të mazhorancës qeverisëse dhe nga ana tjetër kemi parti politike që kanë qenë në opozitë parlamentare në zgjedhjet parlamentare pararendëse. Po ti referohemi kushteve aktuale rezultojnë se pala e tretë PDIU është pjesë e mazhorancës qeverisëse aktuale por PDIU ka ardhur në këtë mazhorancë qeverisëse pas një viti e gjysëm të qënies së kësaj partie në opozitë. ... Kolegji Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit nisur nga rrethanat e çështjes por edhe pretendimet e palëve në proces çmon se vendimi i KQZ me nr. 386, datë 12.06.2017 duhet ndryshuar pasi kjo vendimmarrje është marrë në kundërshtim me përkufizimet ligjore të nenit 95 dhe 96 të Kodit Zgjedhor. Kjo për faktin ashtu siç shihet dhe nga dispozitat ligjore ligjvënësi ka përcaktuar termin mazhorancë parlamentare dhe opozitë parlamentare referuar koalicioneve dhe rezultateve të zgjedhjeve pararendëse parlamentare për Kuvendin e Shqipërisë".

5. Të tre këto vendimmarrje i përkasin periudhës pas hyrjes në fuqi të K.Zgjedhor aktual, pra trajtojnë të njëjtat dispozita të K.Zgjedhor, megjithatë interpretimi që i bën Kolegji Zgjedhor koncepteve të "partitë e shumicës qeverisëse" dhe "partitë e opozitës parlamentare" është i ndryshëm në secilin prej rasteve. - Në vitin 2009, Kolegji Zgjedhor për të përcaktuar statusin e PDK, i referohet periudhës më të gjatë që fillon nga zgjedhjet parlamentare të vitit 2005 deri në momentin e përcaktimit të partive që do të propozonin anëtarët e GNV-ve për zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2009, dhe jo periudhës së fundit kur kjo parti nuk ishte më pjesë e mazhorancës qeverisëse, duke e relativizuar këtë status sipas harkut kohor që një parti politike

brenda një legjislature ka qenë pjesë e mazhorancës qeverisëse apo opozitës parlamentare.

- Në vendimmarrjen e vitit 2015, Kolegji Zgjedhor, përcaktimin nëse një parti politike i përket “shumicës qeverisëse” apo “opozitës parlamentare” e bazon te aktualiteti i vendimmarrjes së KQZ duke cituar se “Është fakt se paditësi PDIU, aktualisht është parti e shumicës qeverisëse, dhe si e tillë asaj i lind e drejta të propozojë për anëtarin e tretë të GNV-së, në hedhjen e shortit ...”. - Ndërkohë në vendimmarrjen e vitit 2019, Kolegji Zgjedhor, përcaktimin nëse një parti politike është pjesë e “shumicës qeverisëse” apo “opozitës parlamentare” e lidh vetëm me çastin e konkurrimit dhe rreshtimit të saj për zgjedhjet pararendëse për Kuvendin e Shqipërisë, pavarësisht aktualitetit në momentin e propozimit të antarëve të GNV-ve.

6. Jurisprudenca e pakonsoliduar, madje kontradiktore e Kolegjit Zgjedhor në lidhje me interpretimin e neneve 95 dhe 96 të K.Zgjedhor sa i përket cilësimit të një partie politike si pjesë e “shumicës qeverisëse” apo “opozitës parlamentare” na çon drejt interpretimit literal të nenit 183 pika 8 të K.Zgjedhor ku parashikohet se “8. Në zgjedhjet e para të përgjithshme dhe në zgjedhjet e para vendore, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, e drejta për propozimin e antarëve të KZAZ-ve, KQV-ve dhe të GNV-ve përcaktohet sipas rezultatit të zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2017 dhe konfigurimit shumicë-pakicë të Kuvendit në çeljen e tij, menjëherë pas këtyre zgjedhjeve”. Në këtë kuptim, konfigurimi shumicë-pakicë i Kuvendit, në lidhje me propozimet për antarët e GNV-ve duhet të kryhet bazuar në çeljen e tij pas këtyre zgjedhjeve. Ajo që del në pah sipas kësaj dispozite kalimtare, ka të bëjë dhe me terminologjinë që përdoret, sepse e drejta për propozim përcaktohet bazuar në dy elementë -1. Sipas rezultatit të zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2017; dhe 2. Konfigurimit shumicë-pakicë të Kuvendit në çeljen e tij menjëherë pas këtyre zgjedhjeve.

7. Po ashtu, sipas interpretimit sistematik e teleologjik të harmonizuar të pikës 2 të nenit 95 dhe pikës 8 të nenit 183 të Kodit Zgjedhor, ashtu edhe të interpretimit logjik të tyre, rezulton se antarë të KZAZ-ve, KQV-ve dhe GNV-ve mund të propozojnë vetëm partitë politike të shumicës parlamentare dhe partitë e opozitës parlamentare të regjistruara në zgjedhje sipas rezultatit të zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2017 dhe konfigurimit shumicë-pakicë të Kuvendit në çeljen e tij, menjëherë pas këtyre zgjedhjeve. Në zgjedhjet e fundit të viti 2017, mbi bazën e rezultateve të të cilave llogaritet propozimi i antarëve të GNV-ve sipas pikës 8 të nenit 183 të Kodit Zgjedhor, rezulton se Partia e Lirisë (ish-subjekti LSI) ka marrë 19 mandate në Kuvend. Ndërsa PDIU ka marrë 3 mandate.

8. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në kuadër të vendimmarrjes së tij për këtë çështje, ka pasur një korrespondencë shkresore me Kuvendin e Shqipërisë. Konkretisht me shkresën nr. 3957 prot., datë 19.04.2023, KQZ ka kërkuar

informacion mbi partitë e shumicës parlamentare dhe ato të pakicës parlamentare të përcaktuara si të tilla në momentin e konstituimit të Kuvendit menjëherë pas zgjedhjeve të përgjithshme si dhe deklaratimet e çdo deputeti mbi përfaqësimin e tij partiak menjëherë pas këtij konstituimi. Sikurse rezulton nga përgjigja e ardhur nga Kuvendi i Shqipërisë, me shkresën nr. 1364/1, datë 20.4.2023 dhe materialit bashkëlidhur saj, Kuvendi shprehet se nuk disponon deklarime të deputetëve për përfaqësimin e tyre partiak. Kuvendi nëpërmjet kësaj shkrese ka përcjellë kopje të njësuara të deklaratimeve të deputetëve për përfaqësimin e tyre në grupe parlamentare. Ky fakt, është vlerësuar i mjaftueshëm nga Komisioneri për të konsideruar PDIU si parti politike e opozitës parlamentare në kuptim të pikës 8 të nenit 183 të Kodit Zgjedhor. Por, nga vlerësimi i materialeve bashkëlidhur përgjigjes së ardhur nga Kuvendi, rezulton se në zbatim të nenit 15 të Rregullores së Kuvendit, menjëherë pas konstituimit të Kuvendit, dy nga tre deputetët e zgjedhur nën siglën e PDIU në zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin në vitin 2017, janë deklaruar menjëherë te pavarur.

9. Sigurisht që Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë si edhe Rregullorja e Kuvendit e kanë shprehur qarte se mandati i deputetit nuk është imperativ. Kjo do të thotë se deputetet kane te drejtën që te mund te ndryshojnë parti politike apo grup parlamentar sipas gjykimit te tyre menjëherë me marrjen e mandatit si edhe gjate ushtrimit te mandatit 4-vjecar. Ky rregull është mishëruar në kapitullin III “Grupet Parlamentare” të Rregullores së Kuvendit, dhe më konkretisht në nenin 15 të saj që ka qenë në fuqi në vitin 2017. Sipas pikës 4 të nenit 15, parashikohej se “Brenda 3 ditëve nga data e zgjedhjes së Kryetarit të Kuvendit, çdo deputet deklaronte me shkrim se në cilin grup parlamentar bën pjesë. Vetëm deputetët që nuk bëjnë deklaratimin e mësipërm ose që nuk i përkasin asnjë grupi parlamentar mund të formojnë grup të përzier.” Pikërisht, duke shfrytëzuar këtë të drejtë, dy nga tre deputetët e zgjedhur nën siglën e PDIU në zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin në vitin 2017, janë deklaruar menjëherë te pavarur në kuptim të pikës 4 të nenit 15 të Rregullores. Duke u vetëdeklaruar si të pavarur ose jashtë (jo pjesë e) ndonjë grupi parlamentar, dy mandate nga tre të zgjedhur nën siglën e PDIU nuk mund të konsiderohen si pjesë e pakicës parlamentare në momentin e çeljes së Kuvendit të Shqipërisë pas zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2017. Duke qenë se në vitin 2017, Rregullorja e Kuvendit nuk e përfshinte dispozitën “Deklarimi i pozicionimit politik të grupeve parlamentare”, parashikuar sot në nenin 15/11 të saj që në pikën 1 parashikon se “Kryetari i grupit parlamentar, brenda një jave nga formimi i grupit, dorëzon një deklaratim me shkrim te Kryetari i Kuvendit për pozicionimin politik të grupit parlamentar “pro” ose “kundër” subjektit politik/koalicionit qeverisës, pasi merr miratimin me shkrim të subjektit politik/koalicionit qeverisës.”, lë për të kuptuar që deklarimi i dy deputetëve të PDIU si “të pavarur”, si në 2017, por po ashtu dhe me ndryshimet e vitit 2019 në Rregulloren e Kuvendit, i bën ata të pakonsiderueshëm si kundër

shumicës qeverisëse në momentin e çeljes së Kuvendit apo pro pakicës parlamentare.

10. Pikërisht deklarimi i dy deputetëve të kësaj partie menjëherë me çeljen e Kuvendit si të pavarur, pra jashtë (jo pjesë e) ndonjë grupi parlamentar opozitar, lë vend për interpretim në kontekstin nëse në këto rrethana edhe vetë PDIU do të konsiderohet si parti politike e opozitës parlamentare. Në mënyrë që të arrihej në një konkluzion të saktë duhet të ish-in bërë sqarime të mëtejshme nga Komisioneri gjatë procedurës së marrjes së vendimit objekt ankimi, për të konkluduar nëse në këtë rast ka vend për aplikim rregullor kalimtar i vendosur në pikën 8 të nenit 183 të Kodit Zgjedhor, lidhur me subjektin zgjedhor PDIU.

11. Në kushtet kur nga dokumentacioni i administruar nuk arrihet të provohet nëse PDIU është parti e opozitës parlamentare, është me rëndësi të sillet në vëmendje se dispozita tranzitore e sipërcituar është e qartë dhe fryma e ligjvënësit nuk mund të tjetërsohet duke i dhënë dispozitës një kuptim dhe qëllim të cilin nuk e ka, e për rrjedhojë duke konsideruar një parti politike si pjesë e partive të opozitës parlamentare pavarësisht se dy nga tre mandatet e përfituara prej saj, janë 1 Shtuar me vendimin nr. 85/2019 të Kuvendit të Shqipërisë deklaruar menjëherë me çeljen e Kuvendit si të pavarur. Në këtë situatë faktike dhe ligjore të PDIU pas çeljes së Kuvendit pas zgjedhjeve të vitit 2017, nuk plotësohet një nga kushtet e kërkuara nga neni 96 pika 1 i K.Zgjedhor që parashikon se "... dhe që kanë fituar jo më pak se dy mandate ...". Interpretimi i kësaj dispozite në raport me nenin 183 pika 8 të K.Zgjedhor që për zgjedhjet e para vendore pas vitit 2020 konsiderohet dispozitë e posaçme, na çon në përfundimin që PDIU të kishte të drejtën e propozimit të anëtarit të katërt të GNV-ve për zgjedhjet e organeve vendore të datës 23 maj 2023, përveç rezultatit në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2017, duhet të kishte të paktën dy mandate në momentin e çeljes së Kuvendit, kusht ky që nuk plotësohet sipas vetë deklaramëve të dy deputetëve të zgjedhur nën logon e PDIU.

12. Për sa më sipër, ne vlerësojmë se kërkesa ankimore e paraqitur nga Partia e Lirisë duhet të pranohet dhe për rrjedhojë KAS të ndryshonte vendimin nr. 404, datë 24.04.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, si dhe të caktonte Partinë e Lirisë si parti politike që i lind e drejta e propozimit për anëtarin e katërt të GNV-ve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Arsyetim shtesë i anëtarit Elvis Çefa:

1. Në vijim të arsyetimit të mësipërm, mendoj se një argument shtesë i cili shkon në favor të pranimit të kërkesës ankimore të paraqitur nga Partia e Lirisë dhe për rrjedhojë të ndryshimit të vendimit nr. 404, datë 24.04.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve është edhe fakti se aktualisht, Shqipëria aplikon një sistem të administrimit zgjedhor me kontroll të ndërsjellë nga persona të emëruar apo të propozuar nga partitë politike garuese. Ky parim është mishëruar në një sërë nenesh të Kodit Zgjedhor shqiptar duke filluar nga neni 29 i cili përcakton përbërjen e

KZAZ-së, neni 36 i cili përcakton përbërjen e KQV, nenet 95 e 96 të cilët përcaktojnë procedurën për ngritjen e Grupeve të Numërimit të Votave (GNV) si dhe atë të përcaktimit të partive që propozojnë anëtarë të GNV-ve dhe më tej duke u rikonfirmuar edhe në ndryshimet e fundit të bëra në vitin 2020 të nenit 183 i cili përcakton formimin kalimtar të organeve drejtuese dhe të administratës zgjedhore. Në këtë kuptim, ligjvënësi në hartimin e Kodit Zgjedhor ka vlerësuar të rëndësishëm parimin e barazpeshës shumicë-pakicë parlamentare.

2. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në vendimin e tij nr. 404, datë 24.4.2023 duke vendosur që të përcaktohet me short ndërmjet Partisë së Lirisë dhe Partisë për Drejtësi Integrim dhe Unitet anëtarë të grupeve të numërimit të votave, ka cënuar parimin e barazpeshës shumicë-pakicë. Vendimi në fjalë nuk ka respektuar parimin e “barazisë së armëve” (barazpeshimin politik në pjesëmarrje në cdo nivel) ndërmjet palëve politike pjesëmarrëse në zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023, parim i mishëruar gjërësisht në dispozitat e Kodit Zgjedhor.

3. Nga ana e Komisionerit në këtë vendimmarrje nuk mund të mos ishte marrë në konsideratë fakti se Partia e Lirisë është parti udhëheqëse e koalicionit zgjedhor “Bashkë Fitojmë”, në përbërje të të cilit janë gjithashtu edhe parti të tjera politike aktive në jetën politikën të vendit. Me anë të vendimit objekt ankimi, ky koalicion, megjithëse është grupimi zgjedhor më i madh dhe më solid i opozitës në Shqipëri dhe një nga 3 subjektet zgjedhore që garojnë në të 61 bashkitë e vendit si për keshillat bashkiakë ashtu edhe për kryetarët e bashkive, është privuar krejtësisht “de facto” nga mundësia e pasjes së numëruesve në Grupet e Numërimit të Votave, çka e vë këtë subjekt zgjedhor në pozita të disfavorshme dhe aspak të barabarta kundrejt subjekteve të tjera në këtë garë elektorale, subjekte që për më tepër nuk garojnë në të gjitha njësitet administrative të vendit. Përkatësisht dy subjektet politike PD dhe PDIU kanë përfutur anëtarë - numërues në GNV, ndërkohë që këto dy subjekte nuk kanë nxjerrë kandidatë për Kryetarë Bashkie në të 61 Bashkitë e vendit. Subjekti zgjedhor PD garon zyrtarisht në 12 bashki me kandidatë për kryetar bashkie, ndërkohë që subjekti PDIU garon vetëm në 1 (një) bashki nga 61 bashkitë e vendit, për Kryetar Bashkie. Pra me anë të vendimit të KSHZ objekt i këtij ankimi, janë barazuar në të drejta subjekte të ndryshme dhe me peshë elektorale dhe politike të ndryshme.

Arsyetimi i anëtarëve Elvin Lako dhe Ilirjan Rusmali:

1. Emërimi i anëtarëve të GNV-ve në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023 rregullohet nga dispozita tranzitore e pikës 8 të nenit 183 të Kodit Zgjedhor. Kjo dispozitë ka hyrë në fuqi me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 101/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar” (d.m.th. në datën 19.08.2020) dhe aktualisht është e vlefshme vetëm për zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023.

2. Dispozita e pikës 8 të nenit 183 të Kodit Zgjedhor përcakton se “në zgjedhjet e para të përgjithshme dhe në zgjedhjet e para vendore, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, e drejta për propozimin e anëtarëve të KZAZ-ve, KQV-ve dhe të GNV-ve përcaktohet sipas rezultatit të zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2017 dhe konfigurimit shumicë-pakicë të Kuvendit në çeljen e tij, menjëherë pas këtyre zgjedhjeve”.

3. Me këtë formulim ligjvënësi jo vetëm ka limituar zbatimin e këtij rregullimit tranzitor, por edhe ka “ngrirë” në kohë kriterin për zgjedhës për emërimin e anëtarëve të GNV-ve. Ky kriter do të bazohet në hulumtimin e konfigurimit shumicë-pakicë në çeljen e Kuvendit, menjëherë pas zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2017. Çelja e Kuvendit ka lidhje me seancën inauguruese të tij, e cila është zhvilluar në datën 9 shtator 2017, si dhe me seancat kushtitutive të tij, të cilat janë zhvilluar në datat 9, 11, 12 dhe 14 shtator 2017, kur Kuvendi verifikoi mandatet e deputetëve, realizoi betimin e tyre, zgjodhi Kryetarin e Kuvendit, miratoi programin dhe përbërjen e qeverisë, bëri ndarjen e deputetëve në komisione dhe delegacione, si dhe zgjodhi organet e tjera të brendshme drejtuese.

4. Neni 96 i Kodit Zgjedhor përcakton, se të drejtën e propozimit për anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV-së mund ta kenë vetëm partitë politike të shumicës parlamentare dhe partitë e opozitës parlamentare, të cilat janë të regjistruara në zgjedhje dhe që rezultojnë se kanë fituar jo më pak se dy mandate në zgjedhjet pararendëse për Kuvendin e Shqipërisë (për shkak të dispozitës tranzitore të pikës 8 të nenit 183, në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2017).

5. Gjithashtu pika 1 e nenit 96 të Kodit Zgjedhor përcakton se kur për vendin e tretë ose të katërt në GNV konkurrojnë dy ose më shumë parti, atëherë përcaktimi i partisë që gëzon të drejtën e propozimit për anëtarin respektiv të GNV-së bëhet nëpërmjet hedhjes së shortit midis partive konkurruese. Shorti hidhet për çdo ZAZ.

6. Mbështetur në kushtet dhe kriteret e shtjelluara më sipër, Komisioneri ka identifikuar qartë listën e partive parlamentare që plotësojnë kriterin e numrit minimal të mandateve. Ato janë: • Partia Socialiste e Shqipërisë me 74 mandate • Partia Demokratike me 43 mandate • Lëvizja Socialiste për Integrim me 19 mandate • Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet me 3 mandate Të katër partitë e sipërcituara janë parti të regjistruara dhe që marrin pjesë në zgjedhjet e datës 14 maj 2023.

7. Dispozita e pikës 8, të nenit 183, të Kodit Zgjedhor është dispozitë tranzitore e miratuar me ligjin nr. 101/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”. Kriteret që kjo dispozitë ka vendosur për kompozimin e GNV-ve janë caktuar të gjitha post factum. Kjo do të thotë, se në momentin e miratimit të ligjit legjislatori e ka pasur të qartë se cilat ishin partitë që kishin të drejtën e propozimit për anëtarët e GNV-ve dhe se legjislatori ka dashur pikërisht që PS, PD, LSI dhe PDIU të propozonin anëtarët e GNV-ve. Legjislatori ka vendosur me vullnet sovran dhe me qartësi ligjore. Kërkesa ankimore ka qëllim që të modifikojë këtë vullnet sovran dhe të zbehë

këtë qartësi ligjore. Vullneti i ligjit nuk modifikohet dot me procedurë administrative.

8. Dispozita e pikës 8 të nenit 183 të Kodit Zgjedhor ka qenë e vlefshme përzgjedhjet parlamentare të vitit 2021 dhe për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2023. Kriteri për “rezultatit e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2017” është zbatuar në të dy rastet njëjloj nga Komisioneri, me vendimin nr.193, datë 31.03.0221 dhe me vendimin nr. 404, datë 24.04.2023. Në zgjedhjet e vitit 2021 PDIU e humbi të drejtën e propozimit jo me arsyetimin se nuk plotësonte kriterin, por me arsyetimin se pjesëmarrja në koalicion zgjedhor ia suprimonte këtë të drejtë. Nëse në zgjedhjet e vitit 2021 PDIU plotësonte kriterin për “rezultatit e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2017”, atëherë ajo e plotëson atë edhe në zgjedhjet e vitit 2023.

9. Ankuesi ngriti pretendimin, se PDIU nuk plotëson kriterin për “rezultatit e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2017”, sepse ka humbur dy mandate në fillim të legjislaturës, për shkak se dy deputetë të zgjedhur nga radhët e palës së interesuar janë deklaruar “deputetë të pavarur”. Deklarimi “i pavaurur” nuk i heq subjektit zgjedhor mandatin e fituar nga zgjedhjet, që kërkon pika 8 e nenit 183 të Kodit Zgjedhor. Deklarimi bëhet për efekt të formimit të grupeve parlamentare dhe ka lidhje me procedurat kushtitutive të Kuvendit, por jo me rezultatit e zgjedhjeve, i cili është i pandryshueshëm. Rezultati i zgjedhjeve nuk provohet nga dokumentacioni parlamentar, por provohet nga vendimi i KQZ-së për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të vitit 2017.

10. Komisioneri ka konkluduar përgjatë procedurës për miratimin e vendimit nr. 404, datë 24.04.2023 se konfigurimi shumicë-pakicë i zgjedhjeve të vitit 2017 ndante në anën e shumicës Partinë Socialiste dhe në anën e opozitës Partinë Demokratike, Lëvizjen Socialiste për Integrim dhe Partinë për Drejtësi, Integrim dhe Unitet. Komisioneri hetoi nëse sjellja parlamentare (historiku i votimit) i çonte subjektet drejt kualifikimit si pjesë e shumicës apo pakicës parlamentare, por doli në konkluzionin se “nuk ka asnjë mekanizëm dhe kriter ligjor për të përcaktuar partinë politike të shumicës dhe të pakicës parlamentare duke ju referuar qëndrimeve në Kuvend të deputetëve të një force politike”.

11. KAS-i çmon se përkufizimi doktrinal i shumicës parlamentare i referohet partisë ose koalicionit të partive parlamentare që formojnë bashkërisht qeverinë e re pas zgjedhjeve (ndryshe shumica qeverisëse) dhe që e mbajnë në jetë atë. Në fillimin e legjislaturës pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2017, Partia Socialiste formoi e vetme qeverinë. Në fillimin e legjislaturës, Partia Socialiste nuk lidhi asnjë marrëveshje koalicioni me asnjë nga partitë e tjera parlamentare. Koalicioni qeverisës me partinë Lëvizja Socialiste për Integrim i legjislaturës pararendëse nuk u rikonfirmua. Partia Socialiste u fut në zgjedhjet e vitit 2017 me kërkesën drejtuar elektoratit që t’a mbështeste me votë për një qeverisje si forcë e vetme, pa koalicion. Rezultati i zgjedhjeve ia krijoi këtë mundësi.

12. Në preambulën e programin e qeverisë, i cili iu prezantua Kuvendit në çelje të legjislaturës, në datën 11.09.2017, ndër të tjera, lexohet “pa dyshim që është privilegj për ne, por është sidomos një sfidë shumë e madhe ky mandat i plotë për të qeverisur të vetëm”. Përbërja e Këshillit të Ministrave, e miratuar me vendimin e Kuvendit nr. 84/2017 “Për miratimin e përbërjes dhe programit politik të Këshillit të Ministrave”, përfshin vetëm eksponentë të Partisë Socialiste. Këto dy dokumente janë prova të faktit juridik, se në çeljen e legjislaturës shumica parlamentare përbëhej vetëm nga Partia Socialiste. Për këtë arsye, ne si anëtarë të KAS-it e gjen të drejtë dhe të mbështetur konkluzionin e Komisionerit për ndarjen që ka bërë për konfigurimin shumicë-pakicë në çeljen e legjislaturës.

13. Votimi ose jo i ligjeve të veçanta nuk është kriter për përcaktimin e shumicës apo pakicës parlamentare. Praktika parlamentare njeh pa fund raste të miratimit të ligjeve me më pak vota se sa përfshin shumica parlamentare, sikurse njeh dhe mjaft raste të miratimit të ligjeve me shumicë më të lartë, deri me unanimitetin e gjithë deputetëve të Kuvendit. Për më tepër, ai nuk është i zbatueshëm në rastin e pikës 8 të nenit 183, sepse kjo pikë kërkon fotografimin e konfigurimit shumicë-pakicë vetëm në momentin e çeljes së legjislaturës së dalë nga zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2017.

14. Gjithashtu nuk formon kriter performanca politike përgjatë legjislaturës. Spektri politik parlamentar përbëhet nga një shumicë partish, secila me identitetin e vet dhe me platformat e veta politike. Ky identitet dhe këto platforma e vendosin një parti politike në një pozicion të caktuar të spektrit politik. Përkatësia opozitare nuk varet nga fakti nëse një parti e opozitës identifikohet si opozitë ekstreme, si opozitë reale, si opozitë tradicionale, si opozitë ideologjike, si opozitë e moderuar, si opozitë konstruktive, si opozitë luajale, apo si opozitë fiktive. Përkatësia tek shumica parlamentare nuk varet nga fakti se një parti identifikohet si aleat besnik, si aleat tradicional, si aleat sezonal, si aleat pragmatist, i qendrueshëm/i paqendrueshëm etj,. Të gjitha këto janë kategori mendimi dhe shprehjeje të natyrës politike, por nuk zbulojnë as lidhin pas vetes kategori të natyrës juridike. Përkatësia si pjesë e koalicionit qeverisës del nga ekzistenca e marrëveshjeve të koalicionit qeverisës dhe anasjelltas, përkatësia si pjesë e pakicës parlamentare del nga mungesa e marrëveshjeve për koalicion qeverisës. Në rastin objekt shqyrtimi këto marrëveshje mungojnë. Për më tepër, performanca politike përgjatë legjislaturës është irrelevante në rastin e pikës 8 të nenit 183, sepse kjo pikë kërkon fotografimin e konfigurimit shumicë-pakicë vetëm në momentin e çeljes së legjislaturës së dalë nga zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2017.

15. Në relacionin shoqërues të vendimit nr. 404, datë 24.04.2023 konstatohet se “nga partitë politike të opozitës parlamentare, Partia e Lirisë (Partia Lëvizja Socialiste për Integritet) dhe Partia “Drejtësi Integritet dhe Unitet” përmbushin kriterin e numrit të mandateve dhe u lind e drejta për të propozuar anëtarin e katërt

të GNV-ve. Rrjedhimisht anëtari i katërt do të përcaktohet në bazë të rezultatit të shortit për çdo ZAZ, ndërmjet Partisë së Lirisë dhe Partisë “Drejtësi Integrim dhe Unitet”. Ne si anëtarë të KAS-it e gjejmë të bazuar në ligj dhe në fakte këtë konkluzion.

16. Ankuesi ka pretenduar me kërkesën e vet ankimore se “vendimmarrja e Komisionerit është diskriminuese dhe shkelet barazia në garë, kjo në kuadër të vetë frymës së kodit elektoral nenet e të cilit dhe ratio duhet të sigurojnë barazpeshimin politik në pjesëmarrje në çdo nivel”. Referencat në “frymë” apo në “ratio legis” që injorojnë gjurmën e ligjit janë të pathemelta. Analiza e “frymës” së ligjit ka kuptim vetëm nëse ajo vihet në përdorim për të qartësuar apo saktësuar kuptimin e gjurmës së ligjit, jo për të anashkaluar ligjin, aq më keq për t’a shkelur atë. Në rastin e dispozitës së pikës 8 të nenit 183 të Kodit Zgjedhor, gjurma e ligjit është shumë e qartë dhe nuk ka nevojë të bëhen përsiatje rreth “frymës” për të kuptuar dhe zbatuar dispozitën. 17. Kompozimi i strukturave të administratës zgjedhore në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë nuk bëhet në bazë të parimit të përfaqësimit politik, por në bazë të parimit të besueshmërisë politike dhe të transparencës. Palët politike kanë të drejtën e propozimit të anëtarëve të trupës zgjedhore, por anëtarët, nga momenti i emërimit, nuk janë përfaqësues politikë, por janë pjesë e një strukture administrimi të centralizuar dhe që i nënshtrohet vetëm ligjit. Administrimi i zgjedhjeve nuk është komponent i garës, prandaj është nonsens juridik të pretendosh “barazi gare” tek përbërja e trupës që administron zgjedhjet.

18. Ankuesi e sheh administratorin zgjedhor si të lidhur me subjektin zgjedhor propozues, Sipas tij, administratori zgjedhor i përket, përfaqëson dhe mbron interesat e subjektit propozues përgjatë administrimit të procesit. Ky këndvështrim është i pambështetur në ligji. Ligji i ka njohur subjekteve zgjedhore të drejtën e caktimit të vëzhgueseve në proces. Vetëm këta i përkasin, përfaqësojnë dhe mbrojnë interesat e subjektit propozues përgjatë administrimit të procesit. Administratorët zgjedhorë janë të punësuar me kohë të pjesëshme të KQZ-së. Ata shpërblehen nga KQZ-ja për punën që kryejnë. Detyra e tyre është administrimi i procesit në dobi të ligjit, gjë që do të thotë, në dobi të të gjithë subjekteve pjesëmarrëse në garë, të atyre që kanë të drejtën e propozimit, por edhe të atyre që nuk e disponojnë këtë të drejtë. Perceptimi i administratorëve zgjedhorë si “përfaqësues” dhe “mbrojtës” të interesave vetëm të subjektit propozues është i kundraligjshëm dhe i kundërvihet drejtpërdrejt parimit të barazisë së armëve në garë, që evokon në kërkesën ankimore ankuesi.

19. Kodi Zgjedhor nuk ka vendosur kriteret barazie, as strikte, as proporcionale, në të drejtën e dy subjekteve konkurruese për të propozuar anëtarin e katërt të GNV-ve. Kodi ia ka besuar rezultatit të shortit të hedhur midis këtyre dy subjekteve për çdo ZAZ. Kriteri që ka vendosur Kodi Zgjedhor është rastësor dhe i tillë duhet të mbetet. Pretendimi i ankuesit se ai duhet të marrë gjithshka, ose së paku proporcionalisht

më shumë se subjekti konkurrues është i pambështetur në ligj. 20. Procedurat e shortit për anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV-së janë përcaktuar me udhëzimin e Komisionerit nr. 5, datë 16.03.2021 “Për procedurat e hedhjes së shortit për caktimin e 18 partive politike që propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit të votave”. Neni 4 i këtij udhëzimi përcakton procedura e shortit kur në listë janë dy parti politike. Rezultati i shortit, për shkak të mënyrës se si hidhet ai, “garanton” një ndarje 50% me 50% për të dy partitë konkurruese. Në vlerësimin tonë si anëtarë të KAS-it, kjo ndarje nuk është në përputhje me pikën 1 të nenit 96 të Kodit Zgjedhor, e cila kërkon hedhjen e shortit për çdo ZAZ. Me shortin e hedhur për çdo ZAZ, rezultati nuk mund të jetë vetëm 50% me 50%, por është totalisht në varësi të shortit. Sa kohë që ligji e parashikon, secilës nga palëve konkurruese u duhet garantuar mundësia përtë provuar shansin dhe jo të shndërrohet ajo në barazi absolute. 21. Ankuesi pretendon se “vendimmarrja objekt ankimi vjen në kundërshtim flagrant me qëndrimin dhe jurisprudencën konstante të Kolegjit Zgjedhor për të tilla çështje, që pas ndryshimeve të fundit të Kodit Zgjedhor në dispozitat relevante që cekin aspektet e GNV”. Citimet në kërkesën ankimore janë pa referenca (përrjashtuar vendimin e Kolegjit Zgjedhor nr. 10, datë 06.06.2019). Lidhur me këtë pretendim, si anëtarë të KAS-it konstatojmë, se pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 101/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar” (ndryshimet e fundit), Kolegji Zgjedhor ka marrë vetëm një vendim që ka për objekt përbërjen e GNV-ve, vendimin nr. 8, datë 19.04.2021, por asnjë vendim që ka për objekt zbatimin e dispozitës së pikës 8 të nenit 183 të Kodit Zgjedhor. Kjo do të thotë se kërkesa ankimore nuk mbështetet dot për arsyetimin e pretendimeve të veta, sikurse pretendon, në “jurisprudencën e Kolegjit Zgjedhor”.

22. Ankuesi pretendon se “nuk bën sens dhe as gjen mbështetje në ligj apo praktikë, që t’i jepet anëtari i numërimit në GNV një apo disa subjekteve që nuk garojnë në të gjithë vendin”.

Këto zgjedhje janë po aq zgjedhje për kandidatët për kryetar bashkie, sa ç’janë zgjedhje për këshillat bashkiake. Identifikimi i tyre vetëm me zgjedhjet për kandidatët për kryetar bashkie nuk është i mbështetur në ligj. Për më tepër, në këto zgjedhje Partia Demokratike që ka të drejtën prioritare të propozimit për të gjithë strukturën e administrimit të zgjedhjeve në të gjithë Shqipërinë nuk ka regjistruar kandidatë për kryetar bashkie në shumicën e bashkive. Administratorët zgjedhorë të propozuar prej saj janë në ushtrim të detyrës në të gjithë territorin.

23. Ankuesi nuk ka asnjë rezervë për këtë fakt, nuk ka rezervë për subjektin Partia Demokratike, por ka rezervë vetëm për konkurruesin e drejtpërdrejtë të tij, për partinë “Drejtësi, Integritim dhe Unitet”. I pyetur nga anëtarët e KAS-it, përfaqësuesi i ankuesit pretendoi se ka një dallim midis palës së interesuar dhe subjektit zgjedhor “Partia Demokratike”, i cili vjen nga fakti se Partia Demokratike i plotëson të dy

kushtet e përcaktuara nga pika 8 e nenit 183 të Kodit Zgjedhor, si kushtin për numrin minimal të mandateve, ashtu dhe kushtin për konfigurimin brenda spektrit opozitar. Në vlerësimin tonë si anëtarë të KAS-it edhe pala e interesuar i plotëson të dyja këto kushte. Ne çmojmë se, për shkak se mungon dallimi midis Partisë Demokratike dhe palës së interesuar në këtë aspekt, qëndrimi i ankuesit ndaj faktit juridik rezulton selektiv, inkohorent dhe i pambështetur në ligj.

24. Neni 96 i Kodit Zgjedhor nuk ka kriter për të drejtën e propozimit të anëtarëve të GNV-së konkurrimit me kandidatë për kryetar bashkie në të gjitha bashkitë, por ka kriter regjistrimit si subjekt në zgjedhje. Këtë kriter e plotëson si ankuesi, ashtu dhe pala e interesuar.

25. Detyrimi i Komisionerit në marrjen e vendimit nr. 404, datë 24.04.2023 ka qenë që të respektojë rigorozisht kushtet dhe kriteret e neneve 96 dhe 183 të Kodit Zgjedhor, jo të balancojë pretendimet e palëve konkurruese. Komisioneri e ka respektuar rigorozisht detyrimin e tij ligjor. Prandaj, në gjykimin tonë si anëtarë të KAS-it, vendimi nr. 404, datë 24.04.2023 është vendim i ligjshëm dhe i bazuar në fakte dhe prova. Ky vendim duhet të lihet në fuqi dhe kërkesa ankimore duhet të rrëzohet... ”.

II. PRETENDIMET E PALËVE NË GJYKIM

9. Ky vendim i KAS kundërshtohet në këtë gjykim nga pala paditëse Partia e Lirisë i cili në kërkesëpadi dhe gjatë gjyimit, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, ka pretenduar se:

- *Nga interpretimi që i bëhet kërkesës ankimore, duke marrë në analizë logjike dhe ligjore aspekte të ligjit dhe të praktikës së konsoliduar gjyqësore nga dy antarët e KAS që kanë votuar pro, trajtohen pa rezerve argumenta të fortë interpretues së frymës së ligjit, të cilët vijnë si pasoje e aplikimit të drejtë të ligjit dhe jo si pasojë e interesave mesquine apo patronazhizmit dhe aktivizmit partiak ashtu si kanë vepruar në argumentat të pa ligjërura dhe pa mbështetura dy anëtarët që kanë votuar kundër, duke u vënë dukshëm në shërbim të një politike e cila pa asnjë bazë ligjore, përdor funksionarë të lartë duke i joshur me poste publike apo privilegje të pa merituar.*
- *Dy antarët nuk japin asnjë argument të karakterit ligjor në frymë të vetë ligjit elektorale, të dakordësisë së aktoreve politikë, të baraspeshimit të konceptit të pjesëmarrjes në zgjedhje në çdo nivel, të barazisë së armëve, të garancisë kushtetuese të një procesi shumë të rëndësishëm, të legjitimitetit dhe interesit të ligjshëm, apo të çdo koncepti tjetër që vjen në frymën e garancisë të një procesi demokratik votimi.*
- *Jo vetëm kaq, po me aktivizmin e tyre politik, si shërbëtor të “denjë” po cenojnë rëndë çdo parim të saktësuar më sipër duke bërë katapultime juridike,*

më ratio extremis, për të cenuar votën, për të dhënë avantazhe të pa drejta forcës politike qeverisëse (forcë nga e cila janë dhe propozuar), duke u vënë në shërbim të hapur, nëpërmjet “ngritjes së kartonit” çdo herë që partia që i ka emëruar ka nevojë për paligjshmëritë e tyre.

- *Sjellim në vëmendje se, PDIU, nuk ka arritur të propozoj candidate për Kryetar Bashkie në 61 bashkitë e vendit. Subjekti PD garon zyrtarisht në 12 bashki me candidate për kryetar bashkie, ndërkohë që subjekti PDIU garon vetëm në 1 bashki nga 61 bashkitë e vendit për Kryetar Bashkie. Atëherë në këtë rast shtrohet pyetje: Votat e kujt do të numërojnë apo mbrojnë këta anëtarë? Cili ka qenë qëllimi i ligjvënësit për të garantuar pjesëmarrje të partive të parashikuara në kod në çdo nivel zgjedhor përfshirë këtu dhe fazën konkludive të procesit elektorale në GNV? Pse nuk është garantuar koncepti i baraspeshimit politik në pjesëmarrje në zgjedhje? Pse nuk janë siguruar kushtet kumulative në kuadër të interesit të ligjshëm që kanë të bëjnë me parashikimet e ligjvënësit në sigurimin e dy ose më shumë mandateve për të lindur e drejta e propozimit të anëtarit të GNV-së dhe fakti që pavarësisht se kjo e drejtë mund ti lind (nëse mund të siguroj këto mandate të deklaruara nga vetë të zgjedhurit) duhet që pjesëmarrja e pretenduesit në garë të jetë në totalin e garës dhe jo vetëm në 1 nga 61 bashkitë garuese?*
- *KSHZ, dhe KAS, në respektim të frymës jurisprudenciale tashmë të konsoliduar të Kolegjit, do të duhet të interpretonte në mënyrë të qartë duke bërë një analizë faktike pa lënë mangët asnjë element vlerësues, duke konkluduar kështu në frymë dhe në gërmë sipas parimeve tashmë të konsoliduara të vendimmarrjeve më të larta si dhe të vetë dakordësisë politike nëpërmjet ndryshimeve të ligjit zgjedhor në vitin 2020.*
- *Me Vendimin Nr. 10, Datë 06.06.2019, Kolegji shprehet se në çdo rast se (analogia legis), duhet (interesi i ligjshëm) duke mbuluar kështu me pjesëmarrje dhe regjistrim të gjitha nivelet e përfaqësimit në KQZ, thënë ndryshe, duke filluar kështu që nga paraqitja e kandidaturave për kandidatët për k. bashkie, për 61 bashki, apo dhe mbulimin e 61 bashkive me kandidatë për këshillat bashkiakë duke saktësuar se: ligjvënësi kur i ka njohur të drejtën e ankimit në Kolegjin Zgjedhor subjekteve zgjedhore, është bazuar në logjikën ligjore se partitë kryesore parlamentare do të përmbushin misionin për të cilin janë krijuar dhe në mënyrat dhe mjetet e parashikuara në ligj për përmbushjen e këtij misioni, pra nëpërmjet pjesëmarrjes në zgjedhje.*
- *Pa ekuivok, Kolegji përcakton pjesëmarrjen në zgjedhje/garë, si element thelbësor i pasjes së legjitimitetit për t’u bërë pjesë e atyre që mund të quhen “privilegjet” e ligjit, apo të drejtat që një subjekt politik mund të përftojë sipas parashikimeve ligjore, gjithmonë duke siguruar pjesëmarrjen në garë.*

- Ndaj gjykojmë se këto veprime arbitrare të KAS duhet të marrin fund dhe mendojmë se Kolegji Zgjedhor të vendosë kufij të qartë lidhur me interpretimin e saktë të dispozitës së nenit 183/8 të Kodit Zgjedhor.
- Përfundimisht, bazuar mbi sa u argumentua më lart, Partia e Lirisë”, kërkon:
- Ndryshimin e Vendimit nr. 71, datë 02.05.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, duke vendosur:
- Caktimin e Partinë e Lirisë si parti politike që i lind e drejta e propozimit për anëtarin e katërt të grupeve të numërimit të votave, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

10. Pala e paditur Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, gjatë gjykimit verbalisht pretendoi se:

- Në lidhje me objektin dhe shkakun ligjor të kërkesëpadisë së palës paditëse Partia e Lirisë e lëmë në çmim të Kolegjit Zgjedhor.

11. Personi i tretë Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet nëpërmjet përfaqësuesit të tij, gjatë gjykimit, pretendoi se:

- Pala paditëse pretendon se “vendimmarrja objekt ankimi vjen në kundërshtim flagrant me qëndrimin dhe jurisprudencën konstante të Kolegjit Zgjedhor për të tilla çështje, që pas ndryshimeve të fundit të Kodit Zgjedhor në dispozitat relevante që cekin aspektet e GNV”. Citimet në kërkesën ankimore janë pa referenca (përgjashtuar vendimin e Kolegjit Zgjedhor nr. 10, datë 06.06.2019). Ky pretendim është absurd pasi se pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 101/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar” (ndryshimet e fundit), Kolegji Zgjedhor ka marrë vetëm një vendim që ka për objekt përbërjen e GNV-ve, vendimin nr. 8, datë 19.04.2021, por asnjë vendim që ka për objekt zbatimin e dispozitës së pikës 8 të nenit 183 të Kodit Zgjedhor. Kjo do të thotë se kërkesa ankimore nuk mbështetet dot për arsyetimin e pretendimeve të veta, sikurse pretendon, në "jurisprudencën e Kolegjit Zgjedhor”.

- Paditësi pretendon se “nuk ben sens dhe as gjen mbështetje në ligj apo praktikë, që t 'i jepet anëtari i numërimit në GNV një apo disa subjekteve që nuk garojnë në të gjithë vendin. Këto zgjedhje janë po aq zgjedhje për kandidatët për kryetar bashkie, sa ç'janë zgjedhje për këshillat bashkiake. Identifikimi i tyre vetëm me zgjedhjet për kandidatët për kryetar bashkie nuk është i mbështetur në ligj. Për më tepër, në këto zgjedhje Partia Demokratike që ka të drejtën prioritare të propozimit për të gjithë strukturën e administrimit të zgjedhjeve në të gjithë Shqipërinë nuk ka regjistruar kandidatë për kryetar bashkie në shumicën e bashkive. Administratorët zgjedhorë të propozuar prej saj janë në ushtrim të detyrës në të gjithë territorin.

- Neni 96 i Kodit Zgjedhor nuk ka kriter për të drejtën e propozimit të anëtarëve të GNV- së konkurrimit me kandidatë për kryetar bashkie në të gjitha bashkitë, por ka kriter regjistrimin si subjekt në zgjedhje. Këtë kriter e plotëson si ankuesi, ashtu dhe pala e interesuar.

Detyrimi i Komisionerit në marrjen e vendimit nr. 404, datë 24.04.2023 ka qenë që të respektojë rigorozisht kushtet dhe kriteret e neneve 96 dhe 183 të Kodit Zgjedhor, jo të balancojë pretendimet e palëve konkurruese, Komisioneri e ka respektuar rigorozisht detyrimin e tij ligjor.

Prandaj, vendimi nr. 404, datë 24.04.2023 është vendim i ligjshëm dhe i bazuar në fakte dhe prova. Ky vendim duhet të lihet në fuqi dhe kërkesa ankimore duhet të rrëzohet.

KQZ apo çdo strukturë e saj në vendimarrjen e saj i referohet ligjit dhe jo qëndrimeve politike.

Në bazë të nenit 158 pika b, të Kodit Zgjedhor, pala e interesuar kërkoi:

Rrëzimin e padisë si të pambështetur në prova dhe në ligj.

III. ARSYETIMI I KOLEGJIT ZGJEDHOR:

12. Kolegji Zgjedhor vlerëson se, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi publik i ngarkuar me përgjegjësinë dhe kompetencën për të ndjekur dhe administruar çdo proces zgjedhor. Organizimi i KQZ-së është i tillë që edhe ankimet administrative ndaj vendimeve që merren në kuadër të një procesi, i parashikon të zgjidhen nga një prej organeve të KQZ-së, që është Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS).

13. Procedura e shqyrtimit të ankimeve nga KAS, ndjek të njëjtat rregulla që janë përcaktuar edhe në Kodin e Procedurave Administrative. Kështu para shqyrtimit të ankimit, është faza paraprake, në të cilën verifikohen elementet formalë të ankimit si dhe kushtet e pranueshmërisë (shih nenet 129 dhe 130 të Kodit Zgjedhor). Vetëm nëse ankimi shpallet i pranueshëm, KAS-i duhet të caktojë seancën për marrjen e vendimit përfundimtar, jo më vonë se 48 orë nga data e shpalljes së vendimit të pranimit (neni 131 i Kodit Zgjedhor). Në këtë mënyrë përcaktohet në ligj edhe afati për shqyrtimin e ankimit zgjedhor.

14. Referuar rastit konkret KAS ka marrë vendim mbi themelin e mosmarrëveshjes duke rrëzuar kërkesën ankimore nr. 53, datë 27.04.2023 të depozituar nga “Partia e Lirisë”, për shkak të mungesës së numrit të kërkuar të anëtarëve për vendimarrje (me dy vota pro dhe dy vota kundër gjithsej katër antarë).

15. Në nenin 21, pika 3 të Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë i ndryshuar parashikohet se:

3. Aktet administrative bazë të KAS-it janë vendimet.

Vendimet merren kur pro tyre votojnë së paku tre anëtarë, përveç vendimit sipas shkronjave “a”, “b” ose “c” të pikës 1, kur objekt i ankimit është kundërshtimi i tabelës përmbledhëse për rezultatin e zgjedhjeve në zonën zgjedhore. Në këtë rast vendimi merret kur pro tij votojnë së paku katër anëtarë.

16. Vendimi konsiderohet i marrë sipas kësaj dispozite ligjore kur pro një varianti kanë votuar së paku tre anëtarë, në të kundërt vendimi nuk konsiderohet i marrë nga ana e KAS.

17. Në rastin konkret KAS nuk ka arritur të marrë një vendim sipas kësaj dispozite ligjore, pasi nga 4 anëtarë që kanë marrë pjesë në votim, dy kanë vendosur pro pranimit të kërkesës ankimore dhe dy anëtarë të tjerë kanë vendosur pro rrëzimit të kërkesës ankimore. Me këtë mënyrë votimi në fakt KAS nuk ka arritur të marrë një vendim lidhur me këtë kërkesë ankimore, pasi nuk kanë votuar pro një varianti së paku tre anëtarë.

18. Vendimi Nr.71, datë 02.05.2023 i KAS në të tilla rrethana është një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm, pasi është nxjerë në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të legjislacionit në fuqi lidhur me procedurën e nxjerrjes së tij.

19. Ky akt administrativ duhet konstatuar si i tillë nga ana e Kolegjit Zgjedhor, duke u rregulluar edhe pasojat juridike që ai ka sjellë, që janë detyrimi i KAS të marrë vendim lidhur me këtë kërkesë ankimore brenda datës 10.05.2023.

20. Lidhur me pjesën tjetër të kërtimeve në padi, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vlerëson se, jemi në kushtet kur duhet vendosur pushimi i gjykimit, pa shqyrtuar në thelb kërkimin për “Ndryshimin e vendimit Nr.71, datë 02.05.2023 të KAS dhe caktimin e Partisë së Lirisë si parti politike që i lind e drejta e propozimit për anëtarin e katërt të grupimeve të numërimit të votave”. Kolegji Zgjedhor vlerëson se, nuk mund të shqyrtojë në thelb këtë kërkim për shkak se, për të nuk është shprehur me një vendim KAS, sipas kërkesës ankimore të paraqitur sa më sipër nga Partia e Lirisë.

21. Për këto arsye padia e paditësit duhet pranuar pjesërisht nga ana e Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, bazuar në Ligjin nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i përditësuar, unanimisht:

V E N D O S I :

1. Pranimin pjesërisht të padisë.
2. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Vendimit Nr.71 Dt.02.05.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve.
3. Detyrimin e Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve të marrë vendim brenda datës 10.05.2023, lidhur me Kërkesën Ankimore Nr.53 Dt.27.04.2023, depozituar nga subjekti zgjedhor “Partia e Lirisë”.
4. Pushimin e gjykimit lidhur me kërkimin tjetër objekt padie.
5. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur.
6. Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.

- U shpall sot në Tiranë, në datë 09.05.2023.

GJYQTARE

Edlira PETRI

GJYQTARE

Blerona HASA

GJYQTAR

Sokol IBI

GJYQTARE

Alma KOLGJOKA

GJYQTARE

Manjola XHAXHO